



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:145439
Datë: 18.10.2024
Numri i dokumentit: 06322592

C.nr. 56/2017

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtoren profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen juridike kontestimore të paditësit, O.S., nga fshati G, Komuna e Vitisë, kundër të paditurve H.M.dhe R.M.nga Vitia, Rr. "Mustaf Koka", me objekt të kontestitit vërtetim pronësisë, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësore të dates 04.10.2024, bie këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

- I.** Vërtetohet se paditësi O.S., nga fshati R.M., Komuna e Vitisë, është pronar i ngastrës kadastrale 01142-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3026 m², në vendin e quajtur "Crnelj" ZK R.M., Komuna e Vitisë, e cila është e regjistruar në emër të të paditurit, H.M.
- II.** Konstatohet e tërhequr padia e paditësit, O.S., kundër të paditurit, R.S..
- III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, me padi, seancë përgatitore, shqyrtim kryesor dhe në fjanë përfunditmare, ka mbetur në tërësi si në padinë e dorëzuar më 03.03.2017, për vërtetim pronësie kundër të paditurëve H.M.dhe R.M.që të dytë nga Vitia, Rr."Mustaf Koka" si trashëgimtarë të vetëm ligjor të N.M., me arsyetimin se H.S.-baba i paditësit, para 40 viteve e kishte blerë ngastrën kontestuese nga N.M., të cilit ia kishte paguar çmimin e kontraktuar, kishte hyrë në posedim të papenguar nga askush. Se me rastin e ndarjes së bashkësisë ekonomike familje, kjo ngastër i kishte takuar paditësit, dhe asnjë prej trashëgimtarëve ligjor nuk ia konteston këtë kërkesë.

Ka propozuar që pas administrimit të provave materiale, kërkesëpadija e tij të aprovohet dhe të vërtetohet se është ponar i ngastrës kontestuese. Ndërsa, e ka tërhequr padinë në raport me të paditurin, R.S..

I padituri H.M.në seancën përgatitore nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se pretendimet e paditësit janë të bazuara, duke shtuar se ngastra kontestuese vetëm formalisht në emrin e tij pas rregullimit të trashëgimisë, andaj, edhe e ka pohuar kërkesëpadinë. Ka propozuar që mos t'i dërgohen ftesa pasi e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësit.

Meqë ngastra ishte blerë nga babai i paditësit, me qëllim të vërtetimit nëse paditësi mund të disponoj i vetëm me këtë kërkesë, gjykata, në seancën e datës 04.10.2024¹ si provë materiale i ka administruar deklaratat noteriale të trashëgimtarëve ligjor të H.S.t, përkatësisht vëllezërve dhe motrave të paditësit, edhe atë: Deklaraten nën betim të datës atë 23.08.2024, me nr. rendor 7007/2024 të K.S., Deklaraten nën betim të datës 23.08.2024 me nr rendor 7008/2024 të E.S.dhe Deklaraten nën betim të datës 18.09.2024 me nr. rendor 7605/2024 të K.S.dhe I.J., të gjitha të dhëna në zyrën e Noterit A.I., e po ashtu e ka administruar edhe ekspertizën e gjeodesizë dhe Certifikatën e pronës me nr.863/2023 e datës 04.05.2023.

Pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura, sipas nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadiës nga i padituri, ka vërtetuar se kërkesat janë të disponueshme për palët, andaj, në kuptim të nenit 148 par 1 të LPK-së i cili përcakton se: “në qoftë se i padituri deri në përfundim të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht gjykata jep pa shqyrtim të mëtejme në të cilin aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (Aktgjykim në baze të Pohimit)”, meqë i padituri mund të disponoj me deklaratën e pohimit, ndërsa, nga deklaratat e vëllezërve dhe motrave të paditësit, ka rezultuar se asnjë prej tyre nuk ia konteston paditësit kërkesën për vërtetim të pronësisë për ngastren kontestuese.

Gjykata e ka konstatuar të tërhequr padinë si në pikën II, duke u bazuar në nenin 261 të LPK-së sipas të cilit “Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”

Për shpenzime të procedurës u vendos sipas nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJILAN DEGA VITI
C.nr.56/2017, datë 04.10.2024

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike:

Kundër pikës I të dispozitivit të aktgjykimit, është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.

Kundër pikës II të dispozitivit nuk është e lejuar ankesa.

¹ E mbajtur në mungesë të të paditurit, të cilit, gjykata ia ka afishuar ftesën në tabelen e kësaj gjykate sipas aktvendimit të datës 26.09.2024